

**UDHËZUES PËR RAPORTIMIN DHE PËRDORIMIN E
STATISTIKAVE TË NORMAVE TË INTERESIT**

DEPARTAMENTI I STATISTIKAVE FINANCIARE

Gusht 2020

Përmbajtja

1.	HYRJE	3
1.1	QËLLIMI	3
1.2	NDRYSHIMET KRYESORE NË LIDHJE ME RREGULLOREN “PËR RAPORTIMET NË BANKËN E SHQIPËRISË TË STATISTIKAVE TË NORMAVE TË INTERESIT”, MIRATUAR NË SHTATOR 2017	3
1.3	RAPORTIMI DHE STANDARDET RAPORTUESE	3
1.3.1	TRANSMETIMI I TË DHËNAVE	4
1.3.2	CILËSIA E TË DHËNAVE	4
1.3.3	STANDARDI MINIMAL PËR RAPORTIM	4
1.3.4	POLITIKAT RISHIKUESE	4
2.	PËRKUFIZIME	5
3.	LLOJI I NORMËS SË INTERESIT	8
3.1.1	NORMA VJETORE E PRANUAR (AAR)	8
3.1.2	NORMA EFEKTIVE E INTERESIT SIPAS PËRKUFIZIMIT TË NGUSHTË (NDER)	9
3.1.3	NORMA EFEKTIVE E INTERESIT	9
4.	MBULIMI	11
4.1	NORMAT E INTERESIT PËR SASITË GJENDJE	11
4.2	NORMAT E INTERESIT PËR SASITË E REJA	11
4.2.1	FLUKSET E REJA MBI DEPOZITAT NJËDITORE, DEPOZITAT E SHLYERA ME NJOFTIM, BORXHIT TË ZGJERUAR TË KARTAVE TË KREDITIT, KREDIVE QARKULLUESE DHE OVERDRAFT-EVE	11
4.2.2	DEPOZITAT ME AFAT	12
4.2.3	NORMAT E INTERESIT TË NDRYSHUESHME	12
4.2.4	NDRYSHIMET NGA NORMAT FIKSE NË NORMA TË NDRYSHUESHME OSE ANASJELLTAS	12
4.2.5	KREDITË ME TRANSHE	12
5.	PERIUDHA E REFERENCËS	14
6.	KATEGORITË E INSTRUMENTEVE	15
6.1	NDARJA SIPAS SEKTORIT	15
6.2	NDARJA SIPAS LLOJIT TË INSTRUMENTIT	15
6.3	NDARJA SIPAS MADHËSISË SË KREDISË	16
6.4	NDARJA SIPAS MATURITETIT ORIGINAL, MATURITETIT TË MBETUR, PERIUDHËS SË FIKSIMIT TË NORMËS SË INTERESIT	16
6.5	KLASIFIKIMI I HUAVE TË SIGURUARA ME KOLATERAL DHE/OSE GARANCI	17
6.6	DALLIMI MIDIS “KREDISË SË RE TË PASTËR” DHE “KREDIVE TË RINEGOCIURA”	18

1. HYRJE

1.1 Qëllimi

Udhëzuesi për kompilimin e statistikave të normave të interesit përcakton kërkesat raportuese për qëllime statistikore të institucioneve të kreditit pranë Bankës së Shqipërisë dhe është ndërtuar për t'u ardhur në ndihmë institucioneve për plotësimin e formularëve raportues, si dhe përdoruesve për qëllime analitike.

Formularët e normave të interesit plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Rregulloren (EC) Nr. 1072/2003, 24.9.2013 (ECB/2013/34), amenduar me rregulloren e Bankës Qendrore Evropiane (BQE) të datës 8.7.2014 (ECB/2014/30), në lidhje me statistikave të normave të interesit të aplikuara nga institucionet financiare monetare (IFM), përveç Bankës Qendrore, dhe fondeve të tregut të parasë, për depozitat dhe huatë ndaj individëve dhe korporatave jofinanciare.

Në shtator të vitit 2017, si rezultat i procesit të përshtatjes dhe harmonizimit me EU *acquis communautaire*, u miratua rregullorja "Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit". Institucionet monetare financiare (bankat) plotësojnë formularët përkatës vetëm për zyrat rezidente në territorin e Shqipërisë.

1.2 Ndryshimet kryesore në lidhje me rregulloren "Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit", miratuar në shtator 2017

Risite që sjell ky bllok i ri statistikor përkufizohen në:

- Hartimi për herë të parë i normave të interesit për sasinë gjendje në fund të periudhës të depozitave dhe kredive;
- Prezantimi për herë të parë i konceptit të normës vjetore të pranuar (AAR) dhe normës efektive të interesit sipas përkufizimit të ngushtë (NDER);
- Harmonizimi i metodologjisë së përkufizimit të sasisë së re (fluksit të ri) me standardin e BQE-së;
- Prezantim për herë të parë në këtë rregullore i klasifikimit të instrumenteve, sipas afatit fillestar të maturimit, afatit të mbetur dhe periudhës së fiksimit të normës së interesit;
- Prezantim për herë të parë i kohës referencë në llogaritjen e normës mesatare të ponderuar të interesit për sasinë e reja dhe gjendjen në fund të periudhës;
- Prezantim për herë të parë i konceptit të madhësisë së kredisë për korporatat jofinanciare;
- Paraqitja e veçantë e normave të interesit për kreditë e garantuara dhe të kolateralizuara;
- Mbledhja e informacionit të normave të interesit për kredi akorduar ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas sektorëve ekonomikë (klasifikimi NACE Rev.2).

1.3 Raportimi dhe standardet raportuese

Raportimi i formularëve të normave të interesit është pjesë e raportimit automatik të bankave të nivelit të dytë pranë Bankës së Shqipërisë dhe duhet të kryhet brenda 10 ditëve kalendarike pas

periudhës së referencës, në përputhje me standardet e përcaktuara në Sistemin Raportues të Unifikuar (SRU).

Kërkesat minimale që subjektet raportuese duhet të plotësojnë gjatë raportimit, iu referohen standardeve të mëposhtme:

1.3.1 Transmetimi i të dhënave

- (a) Subjektet raportuese duhet të sigurohen që të dhënat e transmetuara t'i përmbahen afatit kohor të përcaktuar, 10 ditë kalendarike nga periudha e referencës.
- (b) Subjektet raportuese duhet të sigurohen që transmetimi i të dhënave duhet t'i përmbahet specifikimeve teknike dhe rregullave validuese të përcaktuara në sistem. Këto rregulla janë subjekt ndryshimesh të herëpashershme sipas nevojave.
- (c) Subjektet raportuese duhet të vënë në dispozicion pranë Bankës së Shqipërisë kontaktet e të paktën 2 personave, të cilët janë përgjegjës për raportimin e formularëve, si dhe përgjigjen mbi ndryshime të rëndësishme në seritë e statistikave të normave të interesit.

1.3.2 Cilësia e të dhënave

- (a) Të dhënat duhet të jenë të sakta dhe konsistente ndërmjet të gjithë formularëve të sistemit raportues të unifikuar.
- (b) Subjektet raportuese duhet të ngarkojnë në sistem të gjithë formularët e plotësuar. Në rastet kur një subjekt nuk mund të japë informacion për një kategori të caktuar, duhet të aplikohet një vlerësim për atë kategori.
- (c) Subjektet raportuese duhet të raportojnë të dhënat për sasi të reja dhe sasi të gjendje me 2 shifra mbas presjes dhjetore, si dhe të dhënat për normat e interesit me 4 shifra mbas presjes dhjetore. Statistikat e normave të interesit si në sasi ashtu edhe në përqindje, do t'i referohen deponitave dhe kredive të emëruara në 3 monedhat kryesore, Lek, Euro, Usd.

1.3.3 Standardi minimal për raportim

- (a) Subjektet raportuese dërgojnë në mënyrë elektronike nëpërmjet sistemit RRS, paketën e formularëve raportues të normave të interesit në përputhje me përkufizimet dhe klasifikimet e përcaktuara në rregullore.
- (b) Subjektet raportuese janë të detyruara të japin informacion shtesë në lidhje me devijimet në seritë e tyre mujore.

1.3.4 Politikat rishikuese

Subjektet raportuese mund të rishikojnë të dhënat e raportuara në periudhat e mëparshme nëse lind nevoja. Rishikimet e kryera si pjesë e gabimeve, riklasifikimeve, përmirësimeve në procedurat hartuese dhe raportuese mund të ndodhin por jo domosdoshmërisht me frekuencë periodike.

2. PËRKUFIZIME

Përkufizimet më të shpeshta, të cilat do të përdoren në këtë udhëzues janë¹:

1. Norma vjetore e pranuar (AAR) – një normë interesi e dakordësuar në marrëveshjen ndërmjet bankës dhe një klienti (individ apo korporatë jofinanciare) e llogaritur mbi një bazë vjetore dhe e kuotuar në përqindje. Norma e interesit nuk do të përfshijë komisionet, shpenzimet administrative dhe shpenzime të tjera për kredinë dhe depozitat.

2. Norma efektive e interesit (NEI) – ka të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas shkronjës “a” të pikës 2 të nenit 4 të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”, miratuar me vendimin nr.59, datë 29.8.2008 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar.

3. Norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë (NDER) – është një normë vjetore interesi, e cila barazon vlerën aktuale të të gjitha angazhimeve të ardhme ose ekzistuese (depozita ose kredi, pagesat ose ripagime, pagesa interesi), të ndryshme nga komisione/shpenzime, që rezultojnë nga termat dhe kushtet e marrëveshjes midis subjektit raportues dhe klientit (individ apo korporatë jofinanciare).

4. Periudha fillestare e fiksimit të normës së interesit – është periudha fillestare për të cilën është rënë dakord me nënshkrimin e kontratës, gjatë së cilës vlera e normës së interesit nuk do të ndryshojë. Periudha fillestare mund të jetë më e vogël ose e barabartë me maturitetin fillestar të një huaje.

5. Linjat e kredive (kreditë qarkulluese) – janë kreditë me këto karakteristika:

- a. kredimarrësi mund të tërheqë fonde në sasi të rëna dakord, pa njoftuar më parë huadhënësin;
- b. shumën e kredisë në dispozicion mund të luhatet si pasojë e tërheqjeve dhe shlyerjeve të huasë;
- c. kredia mund të përdoret në mënyrë të përsëritur;
- d. nuk ka asnjë detyrim për të shlyer kredinë në baza të rregullta.

6. Overdraft – është kontrata e kredisë, sipas së cilës banka i jep kredimarrësit mundësinë e disponimit të fondeve në llogarinë e tij rrjedhëse, që tejkalojnë gjendjen aktuale të fondeve në këtë llogari ose premtori t’i japë kredi mbajtësit të kartës së kreditit, deri në një kufi të paracaktuar në kontratë.

7. Kredi për blerje banese – është kredia dhënë individëve me qëllim blerje banese, apartamenti ose toke, për ndërtim (shtëpi/apartament), përfshirë huatë hipotekare dhe huatë për rikonstrukcion, të cilat shtojnë vlerën ekonomike të banesës (shtëpisë, apartamentit).

8. Kredi dyniveloze përmes kartave të pagesës – është kredia, që jepet nga banka për individë dhe korporata jofinanciare, përmes kartave të debitit të shtyra dhe kartave të kreditit në dy nivele pagese si kredi lehtësuese dhe kredi të zgjeruar.

¹ Për informacion më të zgjeruar në lidhje me përkufizimet, referojuni rregullores nr. 48/2017 “Për raportimet në Bankën e Shqipërisë të statistikave të normave të interesit”.

9. Kredi lehtësuese e kartës së kreditit – është kredia që jepet nga banka për individë dhe korporata jofinanciare, si mbajtës të një karte krediti, me interes 0%, në periudhën nga data e përdorimit të saj deri në datën së faturimit.

10. Kredi e zgjeruar e kartave të kreditit – është shuma e mbetur në llogari (e papaguar), pas datës së faturimit përkatës, mbi të cilën zakonisht paguhet interes më i lartë se zero për qind, për të cilën konsumatori duhet të paguajë këste mujore minimale për të shlyer të paktën pjesërisht borxhin e zgjeruar të kartës së kreditit.

11. Kredi të rinegociuara – janë ato kredi, kontratat e të cilave janë rinegociuar (rishikuar), duke përfshirë aktivisht kredimarrësin në ndryshimin e termave dhe kushteve të një kontrate ekzistuese, përfshirë normën e interesit.

12. Depozita njëditore – janë depozita lehtësisht të konvertueshme në parà dhe/ose drejtpërsëdrejti të transferueshme, sipas kërkesës nëpërmjet mjeteve të pagesave të përdorura gjerësisht, të tilla si: çeqet, debitimi ose kreditimi i drejtpërdrejtë, apo mjeteve të tjera të pagesës, pa vonesa, kufizime dhe gjoba. Këto depozita gjithashtu përfshijnë:

- a. teprica (kreditore) në llogari (me ose pa interes), të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në para, sipas kërkesës në fund të ditës së punës kur është bërë kërkesa pa kufizime dhe gjoba, por që nuk janë të transferueshme;
- b. teprica (kreditore) në llogari (me ose pa interes), që përfaqësojnë parapagime (për shembull karta të parapaguara);
- c. kredite për t'u paguar një ditë pas ditës që është akorduar kredia.

13. Maturiteti fillestar (original) – është periudha e fiksuar e kohëzgjatjes së një kontrate (depozite/kredie), përpara së cilës nuk lejohet tërheqja/shlyerja, ose shoqërohet me penalitet.

14. Maturiteti i rënë dakord (me afat të caktuar) – periudha e kohës që nga data e fillimit të transaksionit deri në datën e fundit të dakordësuar. Maturiteti i pranuar është karakteristikë për depozitat.

15. Maturiteti i mbetur – periudha e kohës që nga data e fundit e raportimit deri në datën e fundit të rënë dakord në marrëveshje.

16. Gjendja në fund të periudhës – nënkupton stokun e të gjitha depozitave të vendosura dhe të patërhequra nga klientët e bankave dhe stoku i të gjitha huave të dhëna nga bankat, por të papaguara nga klientët e tyre në ditën e fundit të periudhës së raportimit.

17. Individë - nënkupton sektorin e individëve (ekonomitë familjare) dhe sektorin e institucioneve (institucione jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve) që u shërbejnë individëve:

- (a) individët (Ekonomitë familjare) – përbëhet nga individë dhe grupe individësh, të cilët janë kryesisht konsumatorë, ndajnë të njëjtën banesë dhe të ardhura të përbashkëta dhe konsumojnë kolektivisht mallrat dhe shërbimet. Përfshihen, gjithashtu, individë ose grupe individësh, të cilët janë të angazhuar në aktivitet ekonomik, për shitje në treg ose për konsumin e vetë ekonomisë familjare. Në këtë sektor përfshihen personat fizikë (tregtarët), të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me nenin 2 të ligjit nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- (b) institucionet jo me qëllim fitimi në shërbim të individëve – përbëhet nga institucionet jo me qëllim fitimi, të cilat janë njësi ligjore të pavarura, u shërbejnë ekonomive familjare dhe nuk

prodhojnë për tregun. Institucione të tilla iu sigurojnë ekonomive familjare mallra dhe shërbime falas, ose me çmime që nuk janë ekonomikisht domethënëse.

18. Korporata jofinanciare – janë persona juridikë të angazhuar në aktivitete dhe transaksione ekonomike. Këtu përfshihen të gjitha shoqëritë tregtare, të cilat nuk ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, si dhe e ushtrojnë aktivitetin e tyre në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

3. LLOJI I NORMËS SË INTERESIT

Një përshkrim i llojeve dhe karakteristikave të normave të interesit jepet si më poshtë:

- (c) **normat e dakordësuara:** Të dhënat e mbledhura i referohen normës së interesit që është rënë dakord individualisht midis bankës dhe klientit të saj. Normat e interesit të bankave, pra, dallohen nga normat nominale të reklamuar sepse klienti mund të jetë në gjendje të negociojë me institucionin norma dhe kushte më të mira sesa ato të reklamuar. Normat vjetore të rëna dakord pasqyrojnë kushtet e kërkesës dhe ofertës në tregjet e depozitave dhe të kredive në kohën e marrëveshjes, duke përfshirë edhe konkurrencën e institucioneve dhe të produkteve të tjera financiare.
- (d) **normat me bazë vjetore:** Normat e interesit të IMF-së shndërrohen në bazë vjetore dhe kuotohen në përqindje në vit. Kjo do të thotë që ato marrin parasysh shpeshtësinë e pagesave të interesit (periudhat e kapitalizimit), sa më të shpeshta janë periudhat e kapitalizimit, aq më i lartë është niveli i interesit i MFI. Ekzistojnë dy mundësi për kthimin me bazë vjetore të normave të interesit: ose një formulë algjebrike që çon në AAR, e diskutuar në paragrafin 3.2.1 më poshtë, ose përafrim i njëpasnjëshëm që rezulton në NDER të diskutuar në paragrafin 3.2.2.

Norma mesatare e ponderuar e interesit duhet të hartohet për çdo kategori të caktuar instrumenti, bazuar në totalin e sasive gjendje në datën e raportimit.

3.1 Përshkrimi i tre llojeve të normave të interesit

Statistikat e normave të interesit përfshijnë 3 lloje të ndryshme normash; norma vjetore e pranuar (AAR), norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë (NDER) dhe norma efektive e interesit (NEI). Subjektet raportuese kanë mundësi që të dhënat e normave të interesit për kreditë dhe depozitat t'i shprehin sipas njërës nga 2 normat: AAR ose NDER.

3.1.1 Norma vjetore e pranuar (AAR)

Norma vjetore e pranuar përkufizohet si norma e interesit, e cila vendoset midis subjektit raportues dhe individit apo korporatës jofinanciare për një depozitë apo kredi, e konvertuar në bazë vjetore dhe e kuotuar në përqindje. AAR mbulon të gjitha pagesat e interesit mbi depozitat dhe kreditë, por jo shpenzime/kosto të tjera mbi to. Disagio, e përkufizuar si diferencë midis vlerës nominale të kredisë dhe sasisë së marrë nga klienti, konsiderohet si një pagesë interesi në fillim të kontratës (koha T0) e si rrjedhim duhet të reflektohet në AAR. Nëse për pagesat e interesit bihet dakord dhe vendoset midis subjektit raportues dhe individit apo korporatës jofinanciare që ato të kapitalizohen me intervale të rregullta 14 brenda një viti, p.sh. çdo muaj, apo çdo tremujor, norma e vendosur e interesit do të kthehet mbi baza vjetore, duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$x = \left(1 + \frac{r_{ag}}{n} \right)^n - 1$$

Ku: $x = \text{AAR}$

r norma vjetore e interesit, e vendosur/e rënë dakord midis subjektit raportues dhe individit, korporatës jofinanciare për një depozitë apo kredi, ku datat e kapitalizimit të interesit të depozitës dhe të gjitha pagesat dhe ripagesat e kredisë kryhen me intervale të rregullta, dhe

n numri i periudhave të kapitalizimit të interesit për depozitat dhe periudhave të (r) pagesave të kredisë për një vit, p.sh. “1” për pagesa vjetore, “2” për pagesa gjashtëmujore, “4” për pagesa tremujore dhe “12” për pagesa mujore.

3.1.2 Norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë (NDER)

Norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë NDER është norma e interesit me bazë vjetore, e cila barazon vlerën aktuale të të gjitha angazhimeve përveç komisioneve/ shpenzimeve (depozita ose kredi, pagesa apo ripagesa, pagesa interesi), të ardhme ose ekzistuese, të vendosura midis subjektit raportues dhe individit apo korporatës jofinanciare. NDER përdor përafrimin e njëpasnjëshëm e si rrjedhim aplikohet për çdo tip të depozitave ose kredive, ndërsa AAR përdor një formulë algjebrike, e cila është e aplikueshme për depozitat dhe kreditë me kapitalizim të rregullt të pagesave të interesit.

$$A = \sum_{n=1}^N \frac{CF_n}{(1+i)^{\frac{Dn}{365}}} = \sum_{n=1}^N \left(CF_n \cdot (1+i)^{\frac{-Dn}{365}} \right)$$

Ku:

A është sasia/vëllimi i kredisë/depozitës së dhënë/pranuar;

N numri total i shlyerjeve;

CF_n pagesa e n -të;

DF_n faktori i skontos së pagesës së n -të;

i norma efektive e interesit sipas përkufizimit të ngushtë (ose norma efektive e interesit (NEI));

Dn numri i ditëve nga data kur është dhënë kredia (pranuar depozita) në datën e pagesës së ardhshme n .

Krahasimi midis AAR dhe NDER: Ndryshimi midis këtyre dy normave qëndron në mënyrën e përlllogaritjes me bazë vjetore të interesit. AAR është norma vjetore, e cila aplikohet vetëm në rastet kur kapitalizimi i interesit të depozitave dhe kredive bëhet me intervale të rregullta, ndërkohë që NDER është një përafrim më i saktë matematikor i cili aplikohet për të gjitha kreditë dhe depozitat, sidomos për produktet me *cashflow* jo të rregullt. Të dyja normat e interesit mund të përdoren për qëllime të raportimit të statistikave.

3.1.3 Norma efektive e interesit

Krahas AAR dhe NDER, për normat e interesit për sasi të reja kërkohet edhe raportimi i normës efektive të interesit (NEI), e cila mbulon “koston totale të kredisë për konsumatorin”. Kostoja totale përfshin komponentin e normës së interesit (që është identik me NDER) dhe një komponent tjetër për të gjitha detyrimet shtesë, të tilla si kostot për kërkim informacioni, administrim, përgatitje

dokumentesh, garanci dhe siguracion kredie. Komisionet e angazhimit nuk duhet të përfshihen në llogaritjen e NEI-t, pasi në kohën e finalizimit të marrëveshjes (datën t_0), nuk dihet nëse do të aplikohet apo jo ky komision.

3.2 Trajtimi i taksave dhe subvencioneve

Parimisht, pagesat e interesit të përfshira në NVP/NEIPN pasqyrojnë atë çfarë subjekti raportues paguan për depozitat dhe merr nga kreditë. Nëse midis vlerës që një palë kontraktuese paguan dhe një palë tjetër merr ekziston mospërputhje, vendimtar në këtë rast është këndvështrimi i subjektit raportues. Sipas këtij parimi, *normat e interesit regjistrohen në një bazë bruto përpara tatimit*, meqenëse norma e interesit përpara tatimit pasqyron shumën që subjekti raportues paguan për depozitat dhe merr nga huatë. Krahas kësaj, subvencionet e dhëna individëve/ekonomive familjare apo korporatave jofinanciare nga palët e treta nuk merren parasysh në përcaktimin e pagesës së interesit, pasi subvencionet nuk paguhet ose merren nga subjekti raportues. Për shembull, nëse një subjekt raportues tarifon 10% interes në vit për një hua, por që vetëm 6% në vit do të paguhet nga klienti huamarrës, ndërkohë që pala e tretë paguan diferencën prej 4% në vit si subvencion, atëherë statistikën e normës së interesit duhet të tregojnë një normë interesi prej 10% në vit. Kjo, pavarësisht nëse ofruesi i subvencionit i kryen pagesa direkt klientit apo nëpërmjet subjektit raportues. Për rrjedhojë, në statistikën e normës së interesit do të përfshihen vetëm përbërësit e interesit që tarifon institucioni/subjekti raportues si interes dhe jo pjesa që huamarrësi i paguan subjektit raportues. Prandaj, stimuli qeveritar për një depozitë me kontratë kursimi dhe huadhënieje, për shembull, nuk përfshihet në llogaritjen e normës së interesit.

Në statistikën e normës së interesit përfshihen *normat favorizuese të interesit* që subjektet raportuese aplikojnë për punonjësit e tyre. Kur zbatohen marrëveshje rregullatore, për shembull, tavane dhe dysheme në normat e interesit, këto pasqyrohen tek statistikën e normës së interesit. Prandaj, çdo ndryshim në rregullat që përcaktojnë marrëveshjet rregullatore pasqyrohet në statistikën e normës së interesit si ndryshim i normës së interesit. Në statistikën e normave të interesit duhet të raportohen depozitat dhe huatë me dhe pa interes. Normat negative të interesit për depozitat duhet të përfshihen në normat e interesit të IMF-ve me kusht që këto norma të mos jenë ndryshe nga kushtet e tregut.

3.3 Konvertimi

Subjekteve raportuese u kërkohet të zbatojnë një vit standard prej 365 ditësh për përpilimin e AAR / NDER, d.m.th., efekti i një dite shtesë në vitet e brishtë nuk do të merret parasysh.

4. MBULIMI

Subjektet raportuese (bankat e nivelit të dytë) do të raportojnë normat e interesit për sasi të gjendje dhe për sasi të reja të depozitave e të kredive të individëve dhe korporatave jofinanciare.

4.1 Normat e interesit për sasi të gjendje

Sasi të gjendje në fund të periudhës përkufizohen si stoku i të gjitha depozitave të vendosura nga individët dhe korporatat jofinanciare pranë subjektit raportues dhe stoku i të gjitha huave të dhëna nga subjekti raportues për individët dhe korporatat jofinanciare rezidente në Shqipëri. Bankat raportojnë një normë mesatare interesi të ponderuar me sasinë (vëllimin e tyre) për secilën kategori në formularin FA në ditën e fundit të muajit. Ajo mbulon të gjitha kontratat gjendje në fund të periudhës së referencës.

Kreditë e mëposhtme nuk duhet të përfshihen në llogaritjen e normave të interesit të raportuara në sasi të gjendje:

- Kreditë me probleme; dhe
- Kreditë për ristrukturimin e borxhit me norma nën kushtet e tregut.

Për sa kohë për këto kredi paguhen interesa shumë të ulëta, ose asnjë interes, përfshirja e tyre do të shtrembëronte rezultatet e statistikave të normës së interesit të IMF-ve. Prandaj, të dhënat për kreditë me probleme apo kreditë e ristrukturuara me norma më të ulëta se të tregut duhet të përjashtohen nga statistikat e normës së interesit. Norma e interesit e rënë dakord për një kredi për ristrukturimin e borxhit nuk është rezultat i kërkesës dhe ofertës të përgjithshme të kushteve të tregut e kredisë në kohën e marrëveshjes, por ajo që klienti është në gjendje të paguajë. Për këtë arsye, normat e interesit të kredisë për ristrukturimin e borxhit me norma më të ulëta se të tregut, ashtu si kreditë e tjera me probleme, nuk përfshihen në normat e miratuara nga statistikat e normës së interesit të IMF-ve.

4.2 Normat e interesit për sasi të reja

4.2.1 Flukset e reja mbi depozitat njëditore, depozitat e shlyera me njoftim, borxhit të zgjeruar të kartave të kreditit, kredive qarkulluese dhe overdraft-eve

Për përcaktimin e flukseve të reja të depozitave njëditore, depozitave të shlyera me njoftim paraprak, borxhit të zgjeruar të kartave të kreditit, kredive qarkulluese dhe overdraft-eve, aplikohet një qasje e re nga ajo e përdorur për kategoritë e tjera të flukseve të reja. Depozitat njëditore, depozitat e shlyera me njoftim paraprak, borxhi i zgjeruar i kartave të kreditit, kreditë qarkulluese dhe overdraft-et karakterizohen nga një numër i madh fluksesh hyrëse dhe dalëse gjatë muajit. Rritjet dhe uljet në vlerë për këto llogari rrjedhin më së tepërmi nga arkëtimet dhe pagesat që lidhen me aktivitetin ekonomik të klientit dhe jo domosdoshmërisht me vendimmarrjen investuese të vetë klientit. Për më tepër, është e zakonshme që pjesa më e madhe e depozitave, overdraft-eve, borxhit të zgjeruar të kartave të kreditit të kthehen gjatë periudhës. Për këtë arsye, gjendja në datën e raportimit

konsiderohet të jetë një tregues i përshtatshëm për përcaktimin e flukseve të reja. Normat e interesit për depozitat njëditore, depozitat e shlyera me njoftim paraprak, borxhin e zgjeruar të kartave të kreditit, kreditë qarkulluese dhe overdraft-et duhet të reflektojnë normën mesatare të ponderuar të interesit mbi gjendjen e këtyre llogarive në datën e fundit të periudhës së referencës. Ato përfshijnë pozicionet aktuale të balancave të të gjitha kontratave të aprovuara deri në periudhën e referencës.

4.2.2 Depozitat me afat

Për pjesën më të madhe të depozitave me afat, sasi të reja do të lindin kur një kontratë e re nënshkruhet për herë të parë, kohë në të cilën përcaktohet dhe dakordësohet ndërmjet palëve, sasia dhe norma e interesit përkatëse.

Kur termat dhe kushtet e një depozite të maturuar me afat do të rinegociohen, si rrjedhojë kjo depozitë do të klasifikohet si sasi e re dhe maturiteti i saj do të përcaktohet në bazë të kontratës së re të nënshkruar.

4.2.3 Normat e interesit të ndryshueshme

Ndryshimet që vijnë si rezultat i normave të ndryshueshme të interesit në mënyrë automatike nuk do të konsiderohen si kontrata të reja dhe si rrjedhojë nuk do të përfshihen në raportimet për sasi të reja. Axhustime të tilla do të raportohen vetëm në normat e interesit për sasi të gjendje.

4.2.4 Ndryshimet nga normat fikse në norma të ndryshueshme ose anasjelltas

Një ndryshim nga një normë fikse interesi në normë të ndryshueshme ose anasjelltas nuk do të konsiderohet si kontratë e re dhe si rrjedhojë nuk do të përfshihet në raportimet për sasi të reja. Megjithatë, një ndryshim i tillë do të konsiderohet sasi e re vetëm në rast se nuk ka qenë i parashikuar në kontratën fillestare. Ky rast konsiderohet si rinegocim i kontratës dhe do të raportohet tek normat e interesit për sasi të reja.

4.2.5 Kreditë me transhe

Një klient mund të tërheqë një kredi me transhe në periudha të ndryshme kohore. Fakti që kredia tërhiqet me transhe është e parëndësishme për qëllime të statistikave të normave të interesit për sasi të reja. Në momentin e nënshkrimit të kontratës do të raportohet në formularët e normave të interesit, sasia totale e nënshkruar në kontratë si dhe norma e interesit e dakorduar.

4.2.6 Shtyrjet

Shtyrjet të cilat nuk janë pranuar në fillim të kontratës (t_0) dhe që janë kryer për një datë të së ardhmes (t_2) për kushtet standarde të aplikueshme të këtij momenti kohor të së ardhmes, tregohen si biznes i ri në kohën e kryerjes së rinovimit (t_1) me kushtet standarde të vlefshme në këtë kohë. Vetëm kushtet faktike standarde të pranuar përfshihen në raport me shumat e mbetura.

Nëse një kredi (për sa kohë që nuk është kartë krediti, kredi e rinovueshme apo overdraft) nuk është marrë plotësisht në fillim të kontratës, por me këste në momente të ndryshme kohore (t_0 ,

t_1, \dots, t_n), atëherë kjo kredi do të mbulohet vetëm një herë si biznes i ri me shumën e plotë të kredisë në kohën e kryerjes së marrëveshjes. Këstet individuale duhet të përfshihen në shumat e mbetura në muajt në të cilët ato janë paguar. Nëse një rinegocim termash dhe kushtesh të kredisë ndodh mbas kohës t_0 , shuma e plotë e dhënë dhe ende e papaguar në kohën e kryerjes së rinegocimit duhet të raportohet në kreditë e rinegociuara.

4.2 Trajtimi i kredive me probleme dhe ristrukturimi i borxhit poshtë kushteve të tregut

Në raportimin e statistikave të normave të interesit mbi sasinë gjendje në fund të periudhës, kreditë me probleme dhe kreditë e ristrukturuara jashtë kushteve të tregut *nuk duhet të merren parasysh në llogaritjen e normës së ponderuar të interesit, si dhe gjendjen në fund të periudhës*. Përcaktimi i kredisë me probleme dhe kredive të ristrukturuara, do t'i refererohet përcaktimeve në nenin 4, pika 2 të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 62, datë 14.9.2011, i ndryshuar.

Si indikator, normë interesi poshtë kushteve të tregut do të konsiderohet norma të paktën 200 pikë bazë më e vogël se ajo e tregut aktual.

5. PERIUDHA E REFERENCËS

5.1 Periudha e referencës të normave të interesit për sasi të gjendje

Periudha e referencës së normave të interesit për sasi të gjendje është dita e fundit e muajit. Në ditën e fundit të mbylljes së librave kontabël në ditën e fundit të muajit referencë, normat e interesit duhet të llogariten si mesatare e ponderuar me sasinë e normave të interesit, mbi tepricat stok në llogari të depozitave dhe huave. Në këtë datë, subjekti raportues, duhet të llogarisë normat e interesave korresponduese dhe sasi të, për tepricat stok të depozitave dhe huave të individëve dhe korporatave jofinanciare. Ai duhet të hartojë për çdo kategori instrumentesh, mesataren e ponderuar të normave të interesit. Normat e interesit për gjendjen/tepricat stok mbulojnë vetëm kontratat aktive "në fuqi", në kohën e raportimit të të dhënave.

Normat e interesit dhe sasi të FB mbulojnë vetëm kontratat aktive "në fuqi" në datën e raportimit të të dhënave. Për llogaritë që mund të jenë depozita apo kredi, duhet bërë dallim midis muajve me tepricë kreditore dhe muajve me tepricë debitore. Vetëm teprica në regjistra, në datën e mbylljes së periudhës së raportimit, dita e fundit në muajin referencë, përcakton në këtë muaj, nëse llogaria është një depozitë njëditore apo overdraft.

5.2 Periudha e referencës të normave të interesit për sasi të reja

Periudha e referencës të normave të interesit për sasi të reja është **mesatarja mujore**.

Për secilën nga këto kategori instrumentesh, norma e raportuar e interesit duhet të llogaritet si mesatare e ponderuar e normave të interesit me sasi të për të gjitha rastet e biznesit të ri gjatë periudhës referencë në kategorinë përkatëse. Normat mesatare të ponderuara të interesit duhet të dërgohen/raportohen në Bankën e Shqipërisë së bashku me sasi të biznesit të ri (kontratave të reja) gjatë muajit raportues për çdo kategori instrumenti. Raporti mbulon të gjitha kontratat e reja të administruara gjatë gjithë muajit. Kështu, veprimet që fillojnë dhe përfundojnë brenda periudhës raportuese raportohen si biznes i ri, por nuk mund të llogariten për gjendjen, pasi ajo analizon fundin e muajit. Si rregull i përgjithshëm, faktori përcaktues në kategorizimin e biznesit të ri është data e kontratës në muajin raportues.

Të gjitha rinegociimet e kontratave ekzistuese të depozitave dhe të huave duhet të konsiderohen si biznes i ri, edhe nëse e njëjta kontratë është rinegociuar më shumë se një herë gjatë periudhës referencë.

Marrëveshjet që janë subjekt i një kushti pezullues (p.sh. ato marrëveshje që kërkojnë aprovim nga komiteti i kreditit), në statistikat e normave të interesit do të konsiderohen si biznes i ri vetëm pasi të kenë përmbushur kushtin e pezullimit (të jenë aprovuar). Marrëveshjet, të cilat kanë përfunduar me klientin, por që kërkojnë ende miratimin e tij, do të konsiderohen si biznes i ri nga subjekti raportues, vetëm pasi të jetë firmosur marrëveshja nga klienti.

6. KATEGORITË E INSTRUMENTEVE

Të dhënat statistikore për normat e interesit për gjendjen stok dhe për biznesin e ri (sasitë e reja), sipas formularëve të raportimit, duhet të raportohen vetëm për depozitat dhe huatë e emëruara në Euro, USD dhe Lek. Si rregull i përgjithshëm, të gjitha produktet e reja që i takojnë një kategori të caktuar instrumentesh, duhet të merren parasysh brenda asaj kategorie. Përrjashtime nga ky rregull bëjnë kreditë e këqija dhe kreditë për ristrukturimin e borxhit me norma interesi më të ulëta nga kushtet e tregut. Asnjë nga këto norma nuk duhet të përfshihet në llogaritjen e mesatares së ponderuar të normave të interesit mbi gjendjet (stok) në fund të periudhës e as për biznesin e ri (sasitë e reja). Norma mesatare e ponderuar e interesit duhet të hartohet për çdo kategori të caktuar instrumenti, bazuar në totalin e sasive gjendje në datën e raportimit.

Në statistikat e normave të interesit duhet të përfshihen vetëm veprimet që lidhen me zërat e bilancit. Përrjashtime nga ky rregull bëjnë veprimet *forward* dhe angazhimet e parevokueshme të huadhënies, me marrëveshje me kusht, të cilat përfshihen në statistikat e normave të interesit për sasitë e reja vetëm kur nënshkruhet marrëveshja ose kur rinegociohen kushtet e saj. Nga koha e debitimit dhe e kreditimit, këto përrjashtime duhet të llogariten në sasitë gjendje (stok) sipas afatit fillestar të maturimit të tyre.

6.1 Ndarja sipas sektorit

Normat e interesit për të gjitha depozitat dhe kreditë aplikohen në 2 sektorë:

- (i) individët (S. 14), duke dalluar të vetëpunësuarit;
- (ii) korporatat jofinanciare (S. 11).

6.2 Ndarja sipas llojit të instrumentit

Depozitat njëditore mbulojnë të gjitha depozitat njëditore, të cilat mbartin ose jo interes. Këtu duhet të përfshihen shumat e kartave të parapaguara dhe shumat e lidhura me paranë elektronike. Depozitat njëditore hartohen si gjendje në fund të periudhës raportuese dhe kështu ato nuk duhet të përfshihen në llogaritjen e normave të interesit për gjendjen e depozitave me afat deri në dy vjet të individëve dhe korporatave.

Depozitat me njoftim paraprak të korporatave jofinanciare duhet të hartohen së bashku me ato të individëve (duke përfshirë institucionet jofitimprurëse që u shërbejnë individëve). Depozitat me njoftim 3 muaj, në mbarim të tremujorit, duhet të klasifikohen nën maturitetin “mbi 3 muaj”.

Overdraft-et përfaqësojnë teprica debitore të llogarive rrjedhëse. Norma e interesit në overdraft-e korrespondon me normën e interesit, që aplikohet mbi llogarinë kur një tepricë kreditore (depozitë njëditore) bëhet tepricë debitore (overdraft). Kjo do të thotë që depozitat njëditore dhe overdraft-et lidhen me të njëjtën llogari. Overdraft-et nuk kanë afate fikse maturimi dhe në përgjithësi

lëvrohen pa qenë nevoja që klienti të kontaktojë bankën përpara se sa ta përdorë atë. Zakonisht subjektet raportuese (bankat) vendosin limite përdorimi mbi overdraft-et për individët dhe korporatat jofinanciare. Të gjitha overdraft-et bankare duhet të përfshihen, pavarësisht nëse ato janë brenda ose jashtë limiteve të vendosura me marrëveshje midis subjektit raportues (bankës) dhe individëve dhe korporatave jofinanciare. Si rrjedhim, overdraft-et përfshijnë overdraft-e të aprovuara, overdraft-e të paaprovuara, si dhe llogari rrjedhëse kreditore. Penalitetet në overdraft-et e paaprovuara do të përfshihen në normat e interesit të raportuara në qoftë se ato përfaqësojnë një komponent interesit. Në qoftë se gjoba, si penalitet i overdraft-it nuk është e lidhur me normën e interesit, atëherë ajo nuk do të përfshihet në AAR.

Borxhi i zgjeruar i kartave të kreditit trajtohet në një kategori të veçantë e nuk përfshihet në linjat e kreditit (huatë rrotulluese) dhe overdraft-et. Në këtë rast duhet të raportohet shuma e përgjithshme e marrë nga huamarrësi, pavarësisht nëse është apo jo brenda kufijve të rëna dakord midis huadhënësit dhe huamarrësit lidhur me madhësinë dhe/ose afatin maksimal të huasë.

Të gjitha kartat e kreditit të emëruara në lek, euro dhe usd, do të raportohen në formularët FA (sasitë gjendje). Balancat e kartave të kreditit do të përfshihen në statistikën e kredive. Edhe pse rregullorja e BQE-së nuk e specifikon qartë se në cilin instrument apo sipas cilit afat do të klasifikohet borxhi i kartave të kreditit, praktika e vendeve të tjera tregon se borxhi i kartave të kreditit klasifikohet më shpesh në kategorinë “individë”, “kredi konsumatore dhe kredi të tjera” dhe me maturitetet “deri në një vit”.

Sipas rregullores, të dhënat për volumin dhe normat e interesit do të raportohen të ndara vetëm për borxhin e zgjeruar të kartave të kreditit. Koncepti i fluksit të ri do të përfshijë të gjithë stokun: p.sh. Sasia gjendje për borxhin e zgjeruar të kartave të kreditit në periudhën e raportimit.

6.3 Ndarja sipas madhësisë së kredisë

Ndarja e kredisë sipas madhësisë kërkohet vetëm për sasinë e re, si nënkategori e kredisë dhënë korporatave jofinanciare. Për monedhën vendase, kredia do të ndahet si më poshtë:

- kredi me shumë deri në 35 milionë lekë,
- kredi me shumë mbi 35 milionë dhe deri në 140 milionë lekë,
- kredi me shumë mbi 140 milionë lekë.

Ndërkohë që për monedhat euro/usd do të aplikohen fashat e mëposhtme:

- kredi me shumë deri në 250 mijë euro/usd,
- kredi me shumë nga 250 mijë euro/usd deri në 1 milion euro/usd,
- kredi me shumë mbi 1 milionë euro/usd.

6.4 Ndarja sipas maturitetit origjinal, maturitetit të mbetur, periudhës së fiksimit të normës së interesit

Maturimi origjinal i referohet periudhës së caktuar të jetës së një instrumenti financiar para së cilës nuk mund të blihet ose para së cilës ajo mund të blihet vetëm me një lloj penaliteti.

Maturiteti i mbetur korrespondon me diferencën e periudhës fillestare të maturimit dhe sasisë së kohës që ka skaduar që nga vendosja e marrëveshjes origjinale, domethënë jeta e mbetur e instrumentit financiar, në kushtet e rëna dakord në fillim.

Duhet theksuar se vëllimet e raportuara në formatin ORM duhet të jenë në përputhje me ato të raportuara në formatin FA. Çdo kredi me probleme duhet të përjashtohet nga llogaritja e normës mesatare të ponderuar të interesit për këtë kategori instrumenti.

Për qëllime të statistikave të normave të interesit, **periudha fillestare e përcaktimit të normës së interesit** përkufizohet si periudha fillestare për të cilën është rënë dakord me nënshkrimin e kontratës, gjatë së cilës vlera e normës së interesit nuk do të ndryshojë.

Vlera e normës së interesit konsiderohet e pandryshueshme vetëm nëse përcaktohet në një nivel të vetëm, p.sh. 6% ose lidhet me një normë referencë në një moment të caktuar në kohë, si p.sh (norma 6-mujore e *EURIBOR* më 31 dhjetor 2002 plus 2%). Nëse në fillim të kontratës është rënë dakord për një procedurë për të llogaritur normën e interesit të huasë për një periudhë të caktuar kohe, të tillë si: norma e interesit 6-mujore e *EURIBOR* plus 2% për tre vjet, kjo nuk mund të konsiderohet si periudhë fillestare e përcaktimit të normës, pasi niveli i normës së interesit mund të ndryshojë gjatë tre viteve.

Statistikat për biznesin e ri/sasitë e reja pasqyrojnë vetëm normën e interesit për të cilën është rënë dakord për një periudhë fillestare të fiksimit (përcaktimit) të normës së interesit. Nëse norma e interesit ndryshon automatikisht në një normë të luhatshme pas periudhës fillestare të përcaktimit (siç është rënë dakord më parë), në këtë pikë transaksioni nuk do të raportohet si biznes i ri përsëri, por do të përfshihet në llogaritjen e normave të interesit për gjendjen në fund të periudhës.

6.5 Klasifikimi i huave të siguruara me kolateral dhe/ose garanci ²

Arsyeja për paraqitjen e nënzërave “nga të cilët” për huatë për individët dhe korporatat jofinanciare, për huatë e kolateralizuara është të detajojë më tej huanë për sasinë e re, në disa grupe homogjene rreziku. Objektivi në këtë rast është të përmirësojë përmbajtjen e informacionit statistikor duke mbajtur në konsideratë rrezikun e kreditit si dhe të mundësojë analiza të detajuara si edhe krahasime midis vendeve të ndryshme. Në përfundim të gjitha huatë e kolateralizuara për individët dhe korporatat jofinanciare duhet të raportohen si biznes i ri (sasi të reja), me përjashtim të borxhit të kartave të kreditit, huave rrotulluese (linjave të kreditit) e overdraft-eve, huave të tjera.

Huatë ekzistuese, që përmbushin përkufizimin e biznesit të ri (sasitë e reja), sipas përkufizimeve të këtij udhëzimi për statistikave të normave të interesit, të cilat janë të tilla dhe në kohën e një negociimi të ri të tyre, duhet të kontrollohen përsëri nëse përmbushin parakushtet për t’u klasifikuar si hua të siguruara. Si rrjedhim, deri në maturimin përfundimtar është e mundur që një hua të ndryshojë

² Kolateral/garanci - ka të njëjtin kuptim me përkufizimin sipas nenit 4, pika 2, shkronja “j”, e rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë nga bankat dhe degët e bankave të huaja”, miratuar me vendimin nr.62, datë 14.9.2011 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, i ndryshuar.

statusin e saj. Për qëllime të statistikave të normave të interesit, një hua konsiderohet e siguruar në goftë se koraterali i vendosur është të paktën në të njëjtën vlerë sa shuma e huasë.

Vlera e përgjithshme e kolateralizimit mund të llogaritet si shuma e të gjitha instrumenteve mbrojtëse të ofruara për këtë hua, të cilat njihen në llogaritjen e kërkesave për kapital rregullator (*prudential capital requirements*) sipas metodës përkatëse të përdorur. Kolaterali duhet të konsiderohet për të gjithë kohën e përfundimit të marrëveshjes së huasë, e cila konkludohet duke konsideruar këtë mbrojtje, edhe nëse efekti ligjor i kolateralizimit në këtë moment nuk është ende efektiv.

6.6 Dallimi midis “kredisë së re të pastër” dhe “kredive të rinegociuara”

Për qëllim të statistikave të normës së interesit të IMF-ve, kreditë e rinegociuara për individët dhe korporatat jofinanciare përbëhen nga të gjitha kreditë e flukseve të reja përveç kredive qarkulluese, overdraft-eve dhe kartave të kreditit, që ishin në bilancin e agjentit raportues në fund të muajit para atij referencë.

Rinegocimi i referohet përfshirjes aktive të individit ose të korporatës jofinanciare në përshtatjen e kushteve të kredisë ekzistuese ose kontratës së depozitës, duke përfshirë dhe normën e interesit. Zgjatja e kontratave ekzistuese që ndodh automatikisht, domethënë pa ndonjë përfshirje aktive të konsumatorit, dhe nuk përfshin ndonjë rinegocim të termave dhe kushteve të kontratës, duke përfshirë normën e interesit, nuk është fluks i ri.

Rregullorja kërkon hartimin e shumave të kredive të rinegociuara veçmas nga shumat e fluksit të ri. Qëllimi është mundësia për të dalluar "kreditë vërtet të reja" në kuptimin e parave të reja që mbërrijnë në tregun e kredisë, nga kreditë e rinegociuara ku, sipas përkufizimit, nuk ka para të reja që hyjnë në tregun e kredive.